



AGJENDA PËR REFORMA EVROPIANE NË KOSOVË: SFIDAT E KËTIJ PLANI TË MIRË

Ky publikim është përkrahur financiarisht nga Qeveria e Finlandës dhe ajo e Norvegjisë.

Mohim i përgjegjesisë:

Qëndrimet dhe analizat në këtë raport janë tërësisht të Grupit Ballkanik dhe nuk reflektojnë qëndrimet e donatorëve.

Autor: Naim Rashiti, Drejtor Ekzekutiv dhe Analist i lartë për Ballkan, Grupi Ballkanik për Politika.

SHKURTESAT

KE	Komisioni Evropian
ARE	Agjenda për Reforma Evropiane
PRE	Programi për Reforma Ekonomike
BE	Bashkimi Evropian
BPV	Bruto Produkti Vendor
INF	Institucionet Ndërkombëtare Financiare
IPA	Instrumenti për Asistencë të Para-Anëtarësimi
KASH	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
KPFENZ	Komisioneri për Politika Fqinjësore Evropiane dhe Negociata të Zgjerimit
PKZMSA	Programi Kombëtar për Zbatim të Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asociim
MSA	Marrëveshja për Stabilizim dhe Asociim
KSA	Këshilli për Stabilizim dhe Asociim
KPSA	Komiteti Parlamentar për Stabilizim dhe Asociim
NVM	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme

PËRMBAJTJA

Përmbledhje	2
Rekomandime	3
1. Hyrje	5
2.Çfarë është ARE	7
2.1. Prioritetet e ARE dhe MSA-ja	8
3. Mundësitë dhe Sfidat	10
Përfundime	11
SHTOJCA I - AGJENDA PËR REFORMA EVROPIANE	13
SHTOJCA II - Procesi i anëtarësimit të Ballkanit Perëndimor në BE	22

PËRMBLEDHJE

Në përvjetorin e parë të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA), me 11 nëntor 2016, Kosova dhe BE-ja fillojnë një tjetër dialog, Agjendën për Reforma Evropiane (ARE). Dokumenti përmban 22 prioritete dhe 130 veprime, në fushën e qeverisjes, sundimit të ligjit, rritjes ekonomike, konkurrueshmërisë, si dhe arsimit dhe krijimit të vendeve të punës. Nëse këto veprime do të zbatoheshin plotësisht, do të ndihmonin zbatimin e MSA-së, përmirësimin e qeverisjes dhe mjedisit biznesor, si dhe konsolidimin e shtetit. Nëse BE-ja dëshiron, reformat do ta shpiejnë Kosovën në një fazë tjetër të anëtarësimit, duke siguruar statusin e vendit kandidat, diçka që zyrtarët qeveritar insistojnë. Sidoqoftë, akoma ka pengesa të shumta. Planin e veprimit nuk është në përputhje me programin aktual të reformave, planin e punës të Qeverisë apo edhe me buxhetin. Po ashtu, një sfidë tjetër thelbësore rrjedh edhe nga dallimi në pikat fillestare midis Qeverisë dhe BE-së. E para kërkon që premtimi për shpërblimin e zbatimit të reformave të jepet që në fillim. Në anën tjetër, BE-ja, në pamundësi për të bërë atë premtim, insiston se do të përdorë përkushtimin e Kosovës ndaj këtyre reformave dhe kur të vije koha të avokojë r në favor të statusit kandidat.

Agjenda për Reforma Evropiane është një dialog i nivelit të lartë ndërmjet Kosovës dhe BE-së. Zyrtarisht quhet Dialog i Nivelit të Lartë për Agjendën Evropiane. Kjo nuk do të thotë që do të zëvendësojë dialogun zyrtar të Stabilizim Asociimit, udhërrëfyesin kryesor të dialogut në mes Kosovës dhe BE-së. Sidoqoftë, kjo agjendë do të ketë për synim fushat me prioritet për MSA-në dhe do të shpejtojë zbatimin e saj, ri-organizojë prioritetet e Qeverisë, orientojë fonde nga institucionet financiare ndërkombëtare dhe BE për reforma strukturore, përmirësojë qeverisjen dhe imazhin e Kosovës. Praktikiisht, ARE synon fushat në të cilat Qeveria e Kosovës ka nevojë që të bëjë përmirësime të mëdha. Zbatimi kërkon përkushtim, koordinim ndër-institucional dhe konsensus politik. Dokumenti duhet të miratohet nga Qeveria dhe nga Kuvendi, dhe eventualisht do të jetë udhërrëfyes i Këshillit Kombëtar për Integrim Evropian.

Agjenda e Reformave po ashtu konsiderohet si një platformë për të lëvizur Kosovën në një fazë tjetër të procesit të anëtarësimit, përkatësisht aplikimin për anëtarësim në BE. Dialog i tillë i nivelit të lartë ishte lansuar po ashtu edhe me vende tjera të Ballkanit Perëndimor pasi që ato kishin marrë statusin e shtetit kandidat. Në një skenar ideal, kjo është ajo çfarë do të duhej të ndodh; BE-ja duhet të fillojë një diskutim strategjik se si të përkrahët progresi i Kosovës drejt anëtarësimit në BE. Sidoqoftë, realiteti është shumë më ndryshe. BE-ja nuk mund të bëjë këtë përkushtim tani. Madje, BE-ja as nuk mund të diskutojë për statusin e vendit kandidat për Kosovën; zgjerimi është ndalur për kohë të pacaktuar dhe Kosova nuk është njohur nga pesë vende anëtare të BE-së. Megjithatë, ekziston shpresa se zbatimi i Agjendës së Reformës do të përkrah dhe lehtësojë diskutimet në Bruksel dhe në mesin e vendeve anëtare për anëtarësimin e Kosovës ARE nuk duhet të jetë vetëm një dialog tjetër. Akterët vendor, shoqëria civile dhe shumë diplomatë evropian frikësohen se ARE mund të dështojë po sikur edhe Dialogu i Strukturuar për Sundim të Ligjit, i filluar në vitin 2012. Kësaj here nevojitet një agjendë e qartë. Hyrja në fuqi e MSA-së mund të ndihmojë, por kjo kërkon që Qeveria dhe BE-ja të zotohen dhe përkushtohen fuqishëm në këtë proces. Pengesat e para u shfaqën gjatë negociimit të

Planit të Veprimit; mosmarrëveshjet u shfaqën qysh në fillim të përmbajtjes së faqes së parë. Konteksti aktual nuk është i favorshëm; Kosova vazhdon të përballet me kriza të ashpra dhe të gjata të cilat i kanë bërë institucionet jo-funksionale për një vit e gjysmë. Thirrjet për zgjedhje të parakohshme janë bërë më të zëshme, dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë nuk ka sjellë më shumë njohje nga vendet e BE-së, dhe, sikurse BE nuk ka vullnet të ofrojë diçka që simbolizon zgjerimin.

Sidoqoftë, Kosova dhe BE-ja kanë zhvilluar një dialog të suksesshëm për liberalizimin e vizave, që ka dëshmuar se kur ka koordinim, përpjekje të sigërta dhe stimulime, mund të ketë edhe rezultate pozitive. Megjithatë, dështimi për të përfunduar marrëveshjen e demarkacionit me Malin e Zi, do të lë qytetarët e Kosovës pa liberalizim të vizave. Në këtë rast, besimi i burokratëve dhe qytetarëve në institucionet qeveritare, liderët politikë dhe BE-në do të dëmtohet shumë.

ARE do të jetë e suksesshme vetëm nëse ajo përfshinë akterë të rëndësishëm, përfshirë opozitën, liderët dhe parlamentarët, komunitetin e biznesit, shoqërinë civile. Suksesi po ashtu varet nga transparenca e plotë me media. Konsultimet e ofruara nga Qeveria dhe BE ishin një fillim premtues. ARE kërkon konsensus politik më të gjerë; opozitës duhet dhënë një rol më të madh, në nivel politik dhe në Kuvend. Ndryshimi i Rregullores së Punës dhe legjislacionit tjetër është thelbësor për të siguruar që opozita merr pjesë, luan një rol aktiv në agjendën e BE-së dhe mbikëqyr Qeverinë.

Qeveria dhe BE-ja duhet të përfshijnë shoqërinë civile, e cila duhet të angazhohet në mënyrë aktive për të promovuar zbatimin e ARE. Akterë të specializuar duhet të ofrojnë këshilla dhe përkrahje për politika dhe të avokojnë për rezultate të prekshme. Ata duhet të mbikëqyrin zbatimin dhe të raportojnë për rezultate, përfshirë premtimet e të djave, Qeverisë dhe BE-së.

Deklaratat e vullnetit të mirë vetëm si të tilla nuk do të jenë bindëse. Kosovarët dhe BE-ja duhet që fuqishëm të përkushtohen në zbatimin e reformave, përmirësimin e funksionimit të institucioneve dhe avancimin e rrugës së Kosovës drejt anëtarësimit në BE.

REKOMANDIMET

1. Qeveria, Kuvendi dhe partitë politike duhet të mirëpresin Agjendën e Reformës, të marrin pronësi dhe të vejnë atë në qendër të politikë-bërjes në Kosovë. Të ndërtojnë konsensus për të filluar nga Shtylla Një, Qeverisja e Mirë dhe Sundimi i Ligjit. Zbatimi do të përshpejtojë agjendën e reformës më të gjerë, fuqizojë sundimin e ligjit dhe rrisë zhvillimin socio-ekonomik të vendit.
2. Subjektet politike duhet të përkrahin të gjitha veprimet për të përmirësuar transparençën dhe llogaridhënien e aktiviteteve të tyre si dhe financimin. Të përkrahin zbatimin dhe aprovimin e ligjeve më të mira rreth veprimtarisë dhe financimit të partive politike, të ndërprejnë praktikën e këqija të ndërhyrjes në emërimet e agjencive të pavarura dhe të përkrahin reformën e tyre.

mirëpo prioritetet e vendosura janë më të vështira për t'u zbatuar për shkak të natyrës së tyre, natyra komplekse strukturore e reformave të kërkuara, kapacitetet e institucioneve dhe tregut për të absorbuar këto ndryshime. Prioritizimi i arsimit shënon një ndryshim në politikën e BE-së, e cila deri më tani ka investuar resurse të kufizuara në këtë fushë. Shtylla një është prioriteti KRYESOR. Qeverisja e dobët, mungesa e sundimit të ligjit dhe korrupsioni janë shkaktarët kryesor të stagnimit demokratik dhe ekonomik të Kosovës dhe mungesës së investimeve të jashtme. Zbatimi i plotë i shtyllës së parë në mënyrë të ndjeshme do të përmirësonte imazhin e Kosovës si një shtet funksional dhe demokratik, do të kishte ndikim në shtyllat tjera dhe ndoshta do të hapte rrugën për më shumë njohje, së paku nga disa vende të BE-së që akoma nuk e kanë njohur Kosovën¹⁵.

Më në fund BE flet lidhur me arsimin. Kjo duhet të jetë shtylla kryesore e investimeve. Zyrtar per arsim në Qeveri, Pristinë, Tetor 2016

15 Ja vlen të theksohet që e njëjta metodë ishte përdorur kur BE-ja e lansoi dialogun mbi normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Zyrtarët e Qeverisë së Kosovës kanë pritur që së paku tri shtete që nuk e kanë njohur Kosovën (Sllovakia, Rumania dhe Greqia) do të njihnin Kosovën si rrjedhojë e Marrëveshjes së Brukselit të 19 prillit 2013. Intervistat të Grupit Ballkanik, Prishtinë, qershor 2013.

Partitë tona politike nuk dëshirojnë të auditohen. Sigurisht jo para zgjedhjeve të ardhshme. Shumë njerëz, madje nuk u besojnë raporteve të auditimit.

Deputet, Prishtinë, Tetor 2016

Mos bisedo për ligjet. Subjektet tona dinë se si të kalojnë ligjet por jo se si t'i zbatojnë ato.

Zyrtar qeveritar, Prishtinë, Tetor 2016

të partive politike duhet të jetë prioritet kryesor. Kërkesat e qarta për auditime të pavarura, raportimi financiar dhe konfliktet e interesit duhet të kontrollohen. Sigurimi i emërimeve të bazuara në meritokraci dhe jo-politike, rritja e llogaridhënies së agjencive të pavarura dhe ri-emërimi i anëtarëve të bordit mund të sigurojë përkrahjen e qytetarëve dhe të shoqërisë civile në këtë proces kaq të rëndësishëm. Disa donatorë, sikurse Britania e Madhe, kanë ofruar përkrahje konkrete përmes një kompanie të specializuar për të përkrahur punësimin e profesionistëve në bordet dhe agjencitë e pavarura.

Në anën tjetër, BE-ja duhet të ofrojë përkrahje buxhetore për procesin e reformave dhe të monitorojë nga afër zbatimin në praktikë, sidomos të shtyllës një, krahas përkrahjes së aktiviteteve të shoqërisë civile për monitorimin e ARE. BE-ja duhet të përdorë MSA-n, ARE dhe programe tjera për të nxitur perspektivën evropiane, dhe të trasojë rrugën për arritjen e statusit të vendit kandidat për Kosovën.

SHTOJCA I

AGJENDA PËR REFORMA EVROPIANE

Plani i Veprimit për zbatimin e reformave kryesore

	Prioritetet	Veprimet dhe treguesit
I. Qeverisja e Mirë dhe Sundimi i Ligjit		
1.1	Rishikimi dhe miratimi i legjislacionit që e bënë të detyrueshëm pezullimin dhe/ose largimin e zyrtarëve publik të akuzuar dhe dënuar për korrupsion.	<ol style="list-style-type: none"> Koncept dokumenti mbi ndryshimin e legjislacionit në fuqi për të siguruar pezullimin dhe/ose largimin e detyrueshëm të zyrtarëve publikë të akuzuar dhe dënuar për korrupsion; Miratimi i legjislacionit për të siguruar pezullimin dhe/ose largimin e detyrueshëm të zyrtarëve publik të akuzuar dhe dënuar për korrupsion.
1.2	Ndryshimi i ligjit për konfliktin e interesit dhe rregulloret e ndërlydhura, duke harmonizuar me standardet evropiane dhe duke paraqitur kushtet e sakta në të cilat zyrtarët publik mund të kenë punësim apo emërim shtesë.	<ol style="list-style-type: none"> Ligji për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike duhet të ndryshohet, në harmoni me rekomandimet e BE-së: <ol style="list-style-type: none"> duhet të përcaktohen qartë kategoritë e zyrtarëve publik; duhet të theksohen qartë aktivitete që zyrtarëve iu lejohet dhe iu ndalohe të kryejnë përderisa mbajnë postin; duhet të theksohen qartë aktivitete që zyrtarët e kanë të ndaluar t'i ushtrojnë pas përfundimit të mandatit; duhet të theksohen qartë obligimet e zyrtarëve dhe eprorëve të tyre në situata të konfliktit të interesit; duhet të theksohen qartë procedurat që duhet aplikohen pas paraqitjes së konfliktit të interesit.
1.3	Sigurimi i transparencës dhe llogaridhënies në financimin e partive politike: <ol style="list-style-type: none"> Realizimi i auditimeve të pavarura të financave të partive për vitet 2013-2015; Sigurimi i publikimit të raporteve financiare të partive politike, siç parashihet me ligj. 	<ol style="list-style-type: none"> Publikohen raportet financiare të partive politike dhe të ndërmerren veprim efikas për zbatim kundër atyre që nuk e përmbushin këtë; Të ofrohet financim adekuat për prokurimin e shërbimeve të auditimit për raportet financiare të partive politike; Përzgjidhen auditorët e pavarur nëpërmjet thirrjes së hapur; Ndryshohet ligji për financimin e partive politike për të siguruar transparencë, llogaridhënie dhe zbatim dhe sanksione efikase, në bazë të konsultimeve të gjera publike.
1.4	Realizimi i rishikimit të pavarur të mekanizmave të llogaridhënies së të gjitha institucioneve të pavarura, agjencive dhe organeve rregullatore, përcjelljen e rekomandimeve të tyre dhe miratimin e masave legjislative që përcaktojnë qartë rolet, përgjegjësitë dhe linjat e llogaridhënies së këtyre institucioneve.	<ol style="list-style-type: none"> Kryhet një analizë cilësore e agjencive të pavarura dhe agjencive të pavarura rregullatore (analiza mbi rregulloren e marrëdhënies së punës, pagave, themelimin dhe organizimin e agjencive); Zotohet mbi zbatimin e rekomandimeve që dalin nga analiza cilësore; Zhvillohet një koncept dokument për projektligjin mbi organizimin e administratës publike, shërbimin civil dhe pagat; Miratohet pakoja legjislative mbi shërbimin civil, pagat dhe organizimin e administratës publike.

	Prioritetet	Veprimet dhe treguesit
1.5	Sigurimi se pakoja e planifikuar legjislativë, që mbulon shërbimin civil, pagat dhe organizimin e administratës shtetërore, përgatitet në mënyrë të koordinuar në një proces gjithëpërfshirës dhe të bazuar në dëshmi në bazë të koncept dokumenteve të dakorduara në nivel qeveritar.	<ol style="list-style-type: none"> Hartohen koncept dokumente për projektligjet mbi: shërbimin civil, pagat dhe organizimin e administratës publike; dhe, Të miratohet pakoja legjislativë mbi shërbimin civil, pagat dhe organizimin e administratës publike.
1.6	Sigurimi i një procesi të përzgjedhjes që është transparente, i bazuar në merita dhe jo-politik, në harmoni me ligjin, për të gjitha institucionet e pavarura, agjencitë dhe organet rregullative, si dhe në kompani publike; zbatim i plotë i rekomandimeve nga Agjencia e Kosovës Kundër Korrupsionit (AKK-DLK-3113/15).	<ol style="list-style-type: none"> Ndryshimi i legjislacionit në fuqi për përzgjedhjen e institucioneve të pavarura për të siguruar procedura të fuqishme, transparente dhe të bazuara në merita të përzgjedhjes së kandidatëve: <ul style="list-style-type: none"> Publikimi i CV-ve të kandidatëve në listë të ngushtë; Përfshirja e shoqërisë civile në komisionet përzgjedhëse, në bazë të një përzgjedhje transparente dhe të hapur të përfaqësuesve të shoqërisë civile; Fuqizimi dhe qartësimi i kriterëve minimale për kandidatët përmes përfshirjes së kriterëve të ngjashme me nenin 17 paragrafi 2 i ligjit mbi NP-të, për shembull, në ndryshimet në ligjin mbi konfliktin e interesit, duke i bërë kështu të aplikueshme në të gjitha agjencitë e pavarura dhe organet rregullative. Qeveria zotohet të veprojë sipas rekomandimeve të lëshuara nga AKK më datë 15.02.2016 (AKK-DLK-3113/15) në lidhje me emërimet në 9 borde të NP-ve: <ul style="list-style-type: none"> Formulari/deklarata nën betim ndryshohet për të pasqyruar ligjin, për të gjitha emërimet e ardhshme; ZKM-ja ndërmerr veprim sipas nenit 17.5 të ligjit (d.m.th 17.5 Çdo person i cili mban ose aplikon për një pozitë të drejtorit duhet të japë një deklaratë nën betim në të cilën deklaron se ai/ajo i përmbush kushtet e kualifikimit, pavarësisht dhe ato të përshtatshmërisë profesionale sipas paragrafëve 1-3 të këtij neni. Çdo përgënjeshttrim material – qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca – ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në shkualifikimin e menjëhershëm dhe, nëse është e aplikueshme, largimin e personit); ZKM-ja ndërmerr veprime kundër zyrtarëve që kanë hartuar këtë formë/deklaratë që nuk është në përputhje me ligjin; Sigurohet zbatimin e MM të nënshkruar ndërmjet Kuvendit, Qeverisë në njërin anë dhe Ambasadës së MB në Prishtinë në anën tjetër, për emërimet e anëtarëve të bordit të institucioneve të pavarura dhe agjencive.

	Prioritetet	Veprimet dhe treguesit
1.7	Zbatimi i vendimit e qeverisë të muajit mars 2016 mbi futjen e prokurimit të detyrueshëm, së bashku me afatet kohore të përmendura aty.	<ol style="list-style-type: none"> 1. Fillohet faza e dytë e pilot projektit të e-prokurimit; 2. Zbatohen ndryshimet e ligjit të prokurimit në platformën elektronike; 3. Trajtohen zyrtarët publik në nivel lokal; 4. Certifikohen zyrtarët publik në nivel qendror; 5. Certifikohen zyrtarët publik në nivel lokal; 6. Testohen modulet elektronike të prokurimit; 7. Hartohen udhëzimet operative mbi e-prokurimin. Qeveria duhet ti ofrojë publikut të dhëna standarde të lexueshme nga makina në kohë reale të kontratave të prokurimit.
1.8	Fuqizimi i kapaciteteve të Departamentit Ekonomik dhe Divizionit Fiskal në Departamentin Administrativ të Gjykatës së Shkallës së Parë në Prishtinë, përfshirë në fushat e tatimit dhe doganave, me qëllim të reduktimit të rasteve të grumbulluara.	KGJK do të realizojë një vlerësim të nevojave për rritjen e numrit të gjyqtarëve në Gjykatat Themelore Ekonomike. Vlerësimi do të përcaktojë kostot e buxhetit, si dhe kapacitetet njerëzore të nevojshme për reduktimin e rasteve të grumbulluara në Gjykatat Themelore Ekonomike.
1.9	Vazhdimi i fuqizimit të regjistrimit mbi luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, përfshirë nëpërmjet fuqizimit të kapacitetit të Prokurorisë Speciale që heton dhe ndjek penalisht raste të nivelit të lartë.	<ol style="list-style-type: none"> 1. Plotësim-ndryshimi i Ligjit mbi Prokurorin e Shtetit për të mundësuar rritjen e numrit të prokurorëve në Prokurorinë Speciale, për hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit dhe krimit të nivelit të lartë; 2. Ofrimi i trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve të Prokurorisë Speciale për të kryer hetime financiare dhe për të konfiskuar pasuri.
II. Konkurrueshmëria dhe Klima e Investimeve		
2.1	Promovimi i investimeve të huaja direkte: <ol style="list-style-type: none"> a. Fuqizimi në mënyrë të konsiderueshme i kapaciteteve dhe përmirësimi i organizimit të portfolios së brendshme të Agjencisë së Kosovës për Investime për ti mundësuar përmirësimin e performancës për promovimin dhe mbështetjen e investimeve, sektorit privat dhe zhvillimit të NVM-ve; b. Krijimi i një program të shërbimit dhe kujdesit pasues për investitorët e mundshëm dhe mekanizmin e ankesës që ka kompetenca të mjaftueshme për ofrimin e shërbimeve të tilla. 	<ol style="list-style-type: none"> a.1. Shqyrtim i thellë i fushëveprimit të përgjegjësive të KIESA, aktiviteteve të saj dhe përskrimeve të punës; a.2. Ristrukturimi i KIESA për ti mundësuar që të përmbush me efikasitet përgjegjësitë e saj dhe të zbatojë prioritetet, ndarjen e burimeve të duhura dhe rekrutimin e punonjësve të kualifikuar; a.3. Zhvillimi i kapaciteteve të personelit të KIESA për dizajnimin dhe zbatimin e shërbimeve dhe programeve; a.4. Themelimi i Bordit Këshillues në kuadër të KIESA me pjesëmarrjen e komunitetit biznesor dhe përfshirjen e fuqishme të Zyrës së Kryeministrit. b.1. Përgatitja dhe fillimi i zbatimit të shërbimeve dhe programeve të kujdesit pasues për investitorët.

	Prioritetet	Veprimet dhe treguesit
2.2	<p>Përmirësimi i mjedisit biznesor</p> <p>a. Fokusimi në përmirësimin e treguesve të raportit "Të të bërit biznes" të Bankës Botërore.</p> <p>b. Harmonizoni rregullat me standarde ndërkombëtare të kontabilitetit, auditimit dhe raportimit financiar.</p> <p>c. Reduktimi i barrës rregullative ndaj firmave, në veçanti përmes bërjes transparente të tarifave dhe procedurave të kërkuara për leje dhe licence.</p> <p>d. Prezantimi i ndryshimeve legjislative për të përmirësuar menaxhimin, koordinimin dhe zbatimin e mbikëqyrjes së tregut.</p> <p>e. Përafrimi i legjislacionit, përmirësimi i kapaciteteve të Organeve të Konkurrencës dhe Ndhmës Shtetërore dhe sigurohet që fillojnë zbatimin e mandatit të tyre.</p>	<p>a.1. Këshilli Kombëtar për Zhvillim Ekonomik lehtëson reformën e të bërit biznes duke u fokusuar në rezultatet dhe arritjet në takimet e saj të rregullta;</p> <p>a.2. Përmirësimi i renditjes për zgjidhjen e paaftësisë paguese nëpërmjet zbatimit efikas të kornizës ligjore për falimentimin;</p> <p>a.3. Shkurtimi i procedurave, kohës dhe kostos për marrjen e lejeve ndërtimore, përfshirë nëpërmjet ndryshimit të Udhëzimit Administrativ Nr. 10/2013 për Përcaktimin e Procedurave për Dorëzimin dhe Shqyrtimin e Kërkesave për Kushte Ndërtimore si dhe për Leje ndërtimore në K2 2017;</p> <p>a.4. Regjistrimi online i bizneseve është vënë në dispozicion;</p> <p>a.5. Numri biznesor është unifikuar.</p> <p>b.1. Ligji për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim, i hartuar;</p> <p>b.2. Konsultimet publike me Shoqërinë Civile dhe partnerët zhvillimor, të mbajtura;</p> <p>b.3. Ligji, i miratuar nga Kuvendi.</p> <p>c.1. Ligji i ri për shoqëritë tregtare është konsultuar me shoqërinë civile dhe akterët relevantë dhe është miratuar;</p> <p>c.2. Legjislacioni sekondar i ligjit për shoqëritë tregtare, i miratuar;</p> <p>c.3. Regjistri Qendror Online për Licenca dhe Leje është përditësuar më tej, përfshirë tarifën dhe procedurat e kërkuara për marrjen e lejeve dhe ngarkimi i formularëve të aplikimit në bazën e të dhënave;</p> <p>d.1. Ligji për inspektimet e përgjithshme i hartuar për të reformuar aspektet kryesore procedurale, institucionale dhe funksionale;</p> <p>d.2. Konsultimet publike me shoqërinë civile dhe akterët tjerë relevant, të mbajtura;</p> <p>d.3. Ligji për inspektimet e përgjithshme, i miratuar.</p> <p>e.1. Fuqizimi i procedurave dhe kapaciteteve të brendshme në Autoritetin Kosovar të Konkurrencës për realizimin e hetimeve;</p> <p>e.2. Autoriteti i Konkurrencës duhet të hulumtojë dhe përgatis një raport mbi gjendjen aktuale të monopoleve në tregun në Kosovë, me rekomandimet e duhura;</p> <p>e.3. Përafrohet dhe ndryshohet ligji për ndihmë shtetërore dhe përafrohet legjislacioni sekondar;</p> <p>e.4. Siguroni pavarësinë operative dhe kapacitete të mjaftueshme për të përmirësuar efikasitetin e kontrollit të tij në ndihmën shtetërore.</p>

	Prioritetet	Veprimet dhe treguesit
2.3	<p>Zbatimi në mënyrë sistematike i strategjisë dhe planit të veprimit të miratuar për luftimin e ekonomisë joformale.</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Realizohen vlerësime të pavarura sektoriale të rrezikut, duke u fokusuar në sektorët më të cenueshëm ndaj ekonomisë joformale, krimeve financiare, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit (duke mbuluar aspektin gjinor); 2. Rishikohet Plani i Veprimit duke marrë parasysh të gjeturat nga vlerësimi i rrezikut; 3. Përmirësohet më tej pajtueshmëria tatimore dhe zbatimin në mënyrë që të mbrohet interesi i fiskal i vendit, të sigurohen të drejtat e punonjësve dhe të sigurohet konkurrencë e drejtë në fushën e biznesit; 4. Fuqizohet qasja ndër-institucionale dhe mekanizmat në fushën kundër pastrimit të parave, krimit financiar, financimit të terrorizmit dhe korrupsionit, përfshirë parandalimin, hetimet, vlerësimet dhe operimet (me ndihmën e projektit IPA 2015); 5. Raporte të rregullta tremujore, të përgatitura, konsultuara dhe publikuara** .
2.4	<p>Mbështetja e zhvillimit të NVM-ve:</p> <p>a. Ndërmarrja e masave pasuese bazuar në rekomandimet e vlerësimit rreth „Aktit të Bizneseve të Vogla“.</p> <p>b. Miratimi i masave konkrete për të përmirësuar infrastrukturën dhe standardet e cilësisë.</p> <p>c. Prezantimi i programeve dhe instrumenteve të eksportit për ndihmuar që NMV-të të integrohen në zinxhirët global të vlerës, me qëllim të mbështetjes së ndërkombëtarizimit të tyre.</p> <p>d. Miratimi i masave për të thelluar dhe zgjeruar ndërmjetësimin financiar me qëllim të rritjes së qasjes së NMV-ve në financa.</p>	<ol style="list-style-type: none"> a.1. Struktura e koordinimit të ABV është themeluar, përfshirë pikat e kontaktit për secilën ministri; a.2. KIESA fuqizon përpjekjet e gjera koordinuese të qeverisë për zbatimin e rekomandimeve nga vlerësimi i Aktit të Bizneseve të Vogla, përfshirë nëpërmjet takimeve të rregullta koordinuese. b.1. Avancimi dhe përditësimi i rregullt i uebfaqes, për tu përdorur si një platformë informuese online për bizneset, përfshirë këtu dhe infrastrukturën e cilësisë; b.2. 10 punëtori, të organizuara me qëllim të informimit të bizneseve sa i përket infrastrukturës së cilësisë dhe detyrimet që rrjedhin nga legjislati i specifik vertikal, përfshirë këtu dhe promovimin e uebfaqes si platformë informuese; b.3. Zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve njerëzore në fushën e infrastrukturës së cilësisë, duke përfshirë mënyrën nëpërmjet trajnimit të stafit (organizimi i 30 moduleve të trajnimit) dhe organeve të vlerësimit të konformitetit; b.4. 1,500 standarde, të miratuara me fokus në zonën e harmonizuar; b.5. Laboratorët metrologjik ekzistues, të furnizuar me pajisje; b.6. Ligji mbi shërbime, i hartuar dhe konsultuar me shoqërinë civile dhe akterë tjerë relevant; b.7. Ligji mbi shërbime, i miratuar (transpozimi i pjesës së Direktivës 123/EC mbi shërbime); b.8. Pika e vetme e kontaktit për shërbime, e themeluar dhe funksionale. c.1. Bizneset, të mbështetura për të rritur konformitetin e produktit të tyre (certifikimi i produktit) dhe ndërkombëtarizimin e tyre; c.2. Kosova i bashkohet Rrjetit Evropian të Ndërmarrjeve; c.3. Kosova merr pjesë në programin COSME për mbështetjen e NVM-ve në lehtësimin e qasjes në financa, përmirësimin e qasjes në tregje dhe rritjes së konkurrencës dhe kulturës ndërmarrëse. d.1. Miratimi i ligjit për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare; d.2. Futja në funksion e Fondit Kosovar për Garantimin e Kredive (FKGK).

	Prioritetet	Veprimet dhe treguesit
2.5	Zhvillimi i mëtejshëm i disa statistikave sektoriale, kyçe për politikë bërje në fushën e llogarive kombëtare, statistikave të biznesit, statistikave të energjisë dhe atyre sociale.	<ol style="list-style-type: none"> 1. Vonesat e publikimit, të reduktuara për PBB-të vjetore dhe tremujore përkatëse dhe statistikave të llogarive të qeverisë, përfshirë këtu publikimin në kohë të statistikave financiare të qeverisë me metodologjinë e ESA 2010; 2. Prodhimi dhe publikimi i statistikave afatshkurtra të biznesit, të përmirësuara (vëllimit të prodhimit industrial dhe indekset e çmimeve); 3. Rezultatet nga statistikave të Anketës së Fuqisë Punëtore, të shpërndara në baza tremujore, dhe cilësia e tyre, e përmirësuar; 4. Anketa mbi të ardhurat dhe kushtet e jetesës, e kryer; 5. Publikimi i statistikave të energjisë, të reduktuara dhe statistikave vjetore të efikasitetit të energjisë, të prodhuara në përputhje me standardet ndërkombëtare.
2.6	<p>Përmirësimi i lidhjes rajonale</p> <p>a. Zbatimi i projekteve të investimeve publike individuale me prioritet, në veçanti duke miratuar raportin e rishikuar të zbatimit të klauzolës së investimeve, në bazë të "Listës prioritare të projekteve infrastrukturore".</p> <p>b. Zbatimi i të gjitha 'masave të buta' të mbetura të lidhjes, dhe reformat përkatëse të politikave mbi transportin dhe energjinë.</p>	<ol style="list-style-type: none"> a.1. Qeveria miraton raportin e rishikuar mbi zbatim, për klauzolën e investimeve; a.2. Numri i marrëveshjeve financiare, i ratifikuar në Kuvend në lidhje me projektet brenda Klauzolës së Investimeve, e aprovuar nga KKI dhe Qeveria. <p><u>Energjia</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 6.b.i. Legjislacioni dytësor që rrjedh nga ai primar, i miratuar; 6.b.ii. Çmimet e parregulluara të energjisë: <ol style="list-style-type: none"> 1. Rregulla për vendosjen e çmimeve të operatorit të sistemit të shpërndarjes (Rregulla për Çmimet e OSSH-së), e ndryshuar dhe miratuar; 2. Rregulla për vendosjen e çmimeve të furnizuesit publik të energjisë elektrike (Rregulla për Çmimet e FPEE-së), e miratuar; 3. Rregulla për vendosjen e çmimeve të operatorit të sistemit të transmissiionit dhe të tregut (Rregulla për Çmimet e OST/OT-së), e miratuar. 6.b.iii. Tregu i përbashkët energjetik me Shqipërinë, i krijuar; 6.b.iv. Tregu i aksioneve energjetike me Shqipërinë - KOSTT (një ditë përpara dhe brenda ditës), i krijuar; 6.b.v. Furnizuesit e rinj të energjisë elektrike, të krijuar; 6.b.vi. Marrëveshja ndërmjet KOSTT-EMS, e zbatuar; 6.b.vii. Kodi i rrjetit të KOSTT-it, i harmonizuar me atë të ENTSO-E. <p><u>Transporti</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 6.b.1. Hapja e tregut të transportit; <ol style="list-style-type: none"> 6.b.1.1. Zbatimi i strategjisë së reformës hekurudhore; 6.b.2. Krijimi i një sistemi konkurrues, të besueshëm dhe të sigurt sa i përket transportit; <ol style="list-style-type: none"> 6.b.2.1. Përmirësimi i sigurisë në rrugë. Synimi i uljes së objekteve me 20% krahasuar me vitin e referuar 2014; 6.b.2.2. Lehtësimi i tregtisë dhe transportit; 6.b.2.3. Vendosja e sistemit inteligjent të transportit (SIT) në Rrjetin Kryesor; 6.b.2.4. Krijimi i sistemit funksionues të mirëmbajtjes, duke siguruar që asnjë seksion të mos ketë gjendje të keqe/shumë të keqe; 6.b.3. Rritja e efektivitetit të Procedurave të kalimit të kufirit; <ol style="list-style-type: none"> 6.b.3.1. Marrëveshjet efektive të kalimit kufitar; 6.b.3.2. Zbatimi i strategjisë për Menaxhimin e integruar të kufirit (MIK).

	Prioritetet	Veprimet dhe treguesit
2.7	<p>2.7. Rritja e sigurisë së energjisë dhe miratimi i strategjisë gjithëpërfshirëse të energjisë për periudhën 2017-2026:</p> <p>a. Vendosja për modalitetet e pronësisë për Kosova B dhe për investimet e reja në gjenerimin e energjisë, dhe dekomisionimi i Kosova A.</p> <p>b. Miratimi i Planit të Veprimit të përditësuar mbi burimet e ripërtërishme.</p> <p>c. Vlerësimi i modaliteteve më të mira për krijimin e mekanizmit për financimin e efikasitetit të energjisë dhe masat mjedisore në sektorin publik dhe atë të rezidencial, dhe nxitja e përdorimit të plotë të iniciativave ekzistuese siç është Programi Rajonal për Efikasitet.</p>	<p>7. Miratimi i një strategjie gjithëpërfshirëse të energjisë për periudhën 2016-2025 e cila është në përputhje me standardet mjedisore dhe sociale të BE-së</p> <p>7.a. i. Vendimet për modalitetet e pronësisë së Kosova B, të marra;</p> <p>7.a.ii. Investimet e reja në gjenerimin e energjisë (të gjitha burimet);</p> <p>7.a.iii. Afati i fundit për dekomisionimin e Kosovës A, të jetë fiks;</p> <p>7.b.i. Raporti i dytë mbi ecurinë e zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit për BRE, i përgatitur;</p> <p>7.b.ii. Miratimi i planit për burimet e ripërtërishme, i përditësuar, duke përfshirë masat e duhura për të siguruar që Kosova po arrin 25% të objektivave të energjisë së ripërtërishme në vitin 2020;</p> <p>7.c.i. Misioni i TAIEX për të vlerësuar modalitetet e mekanizmit të financimit për efikasitetin e energjisë dhe masat e marra mjedisore;</p> <p>7.c.ii. Vlerësimi dhe marrja e vendimeve për modalitetet e mekanizmit të financimit për të mbështetur investimet në efikasitetin e energjisë dhe mjedisit;</p> <p>7.c.iii. Miratimi i planit të veprimit 2016-2018 mbi efikasitetin e energjisë;</p> <p>7.c.iv. Miratimi i ligjit mbi performancën e energjisë në ndërtesa;</p> <p>7.c.v. Miratimi i legjisllacionit sekondar, që transponon Direktivën 2010/31/EU nëpërmjet;</p> <p>a) Rregullores për përcaktimin e performancës minimale të energjisë në ndërtesat e reja të banimit, ndërtesat nën renovim dhe llojet e tjera të ndërtesave të banimit;</p> <p>b) Rregullores për certifikatën e performancës së energjisë për ndërtesat e reja dhe ndërtesave të tjera;</p> <p>c) Rregullores për inspektimin e sistemit të ngrohjes dhe pajisjeve për kondicionimin e ajrit.</p>
III. Punësimi dhe arsimit		
3.1	<p>Miratimi dhe zbatimi i Strategjisë Sektoriale për Punësimin dhe Politikën Sociale 2015-2020 dhe miratimi i Planit të Veprimit 2017-2018 për zbatimin e strategjisë.</p>	<p>1. Strategjia Sektoriale është hartuar dhe konsultuar me akterët përkatës, përfshirë komunitetin e donatorëve;</p> <p>2. Strategjia Sektoriale dhe Plani i saj i Veprimit, të miratuara.</p> <p>3. Buxheti për zbatimin e strategjisë është ndarë.</p>
3.2	<p>a. Krijimi i një plani të veprimit për trajtimin papunësisë tek të rinjtë në bazë të një vlerësimi të sfidave dhe duke u fokusuar në përmirësimin e rezultateve të arsimit dhe mbështetjen e kalimit nga shkolla në punë.</p> <p>b. Ndërmarrja e masave për rritjen e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës.</p>	<p>a.1 Plani i veprimit me tregues të qartë për trajtimin e papunësisë tek të rinjtë, është hartuar;</p> <p>a.2 Draft Plani i veprimit është konsultuar me akterët përkatës, përfshirë komunitetin e donatorëve;</p> <p>a.3 Plani i veprimit me tregues të qartë për trajtimin e papunësisë tek të rinjtë, është miratuar.</p> <p>b.1 Rritet asistenca e pranuar nga gratë nga shërbimi i punësimit;</p> <p>b.2 Draft analiza e pengesave në punësimin e femrave është bërë në konsultime me akterët relevant;</p> <p>b.3 Përdorimi i analizës për zhvillimin e masave të duhura për përmirësimin e papunësisë së grave.</p>

	Prioritetet	Veprimet dhe treguesit
3.3	<p>Sigurimi i zbatimit të ligjit mbi agjencinë e punësimit, në veçanti nëpërmjet funksionalizimit të agjencisë për punësim dhe ndarjes së buxhetit të nevojshëm për të siguruar që është në gjendje të iniciojë masat aktive të tregut të punës me rezultate të prekshme.</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Realizimi i një vlerësim të nevojave të tregut të punës (përfshirë mbi AAP); 2. Përzgjedhja e Drejtorit të Agjencisë së Punësimit dhe Bordit Këshillues është përfunduar dhe rregulloret e punës për Agjencinë e Punësimit janë miratuar; 3. Masat aktive të tregut të punës janë zbatuar nga Agjencia e Punësimit (thirrjet për aplikime janë lansuar, mbështetja financiare është dhënë sipas rezultateve të thirrjeve).
3.4	<p>Miratimi i legjislacionit të mbetur që ofron bazën për reforma të politikave në sektorin e arsimit.</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Projektligji i rishikuar mbi arsimin e lartë, i miratuar; 2. Projektligji mbi profesionet e rregulluara në Kosovë, është miratuar; 3. Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021 është miratuar nga qeveria dhe është ndarë buxheti i nevojshëm për të siguruar zbatimin e tij;
3.5	<p>Përmirësimi i cilësisë së arsimit nëpërmjet:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. Rritjes së vijueshmërisë së arsimit parashkollor. b. Realizimi i vlerësimit/ vlerësimit të jashtëm dhe përsheptimi i zbatimit të kurrikulave të reja, përfshirë me tekstet e reja shkollore në arsimin para-universitar. c. Krijimi i mekanizmave për vlerësimin dhe përmirësimin e programeve të trajnimit fillestar dhe në shërbim të mësimdhënësve. d. Përmirësimi i cilësisë së përgjithshme të arsimit të lartë. e. Nxitja e lidhjeve më të mira ndërmjet arsimit të lartë dhe tregut të punës nëpërmjet lehtësimit dhe nxitjes së themelimit të bordeve industriale në universitete të cilat këshillojnë IAL-të mbi rëndësinë e kurrikulavemësimore, identifikimi i mangësive në shkathtësitë e të diplomuarve, pjesëmarrja në trajnim dhe mësimdhënie (vizita, seminare) dhe ofrimi i trajnimeve dhe përvojë në punë praktike për studentët. 	<ol style="list-style-type: none"> a.1 Numri i objekteve publike për kujdesin ndaj fëmijëve të moshës 0-5 vjeç është rritur. a.2 Kurrikula bërthamë për arsimin parashkollor është zhvilluar dhe ka filluar faza e saj e pilotimit; a.3 Korniza e Kurrikulës Bërthamë e Arsimit Para-universitar (i vitit 2011 dhe 2012) është shqyrtuar dhe aprovuar dhe rezultatet e të nxëniet për lëndët dhe klasat është janë zhvilluar në shkolla; a.4 Korniza e Kurrikulës Bërthamë për Arsimin Para-Universitar dhe syllabusi për klasat dhe lëndët është shqyrtuar dhe aprovuar me zbatimin të mëpasshëm në të gjitha shkollat, duke filluar nga viti shkollor 2017/2018. b.1 Mekanizmat për sigurimin e cilësisë të zhvilluara përmes emërimit të koordinatorëve të cilësisë në shkolla dhe krijimit të sistemit efikas për vlerësimin e performancës në shkolla; b.2 Agjencia për Kurrikulë, Standarde dhe Vlerësim është themeluar dhe është plotësisht funksionale; b.3 Projektligji i rishikuar mbi inspektoratin e arsimit në Kosovë është miratuar nga Kuvendi dhe inspektorët kanë filluar aktivitetet e tyre, me inspektorë dhe kapacitete të mjaftueshme. c.1 Krijimi dhe funksionalizimi i Këshillave Industriale; c.2 Shqyrtimi i programeve studimore dhe politikave të regjistrimit. c.3 Projekt propozimi mbi themelimin e bordeve industriale në universitete që këshillojnë IAL-të, është prezantuar; c.4 Propozimi mbi themelimin e bordeve industriale në Universitete që këshillojnë IAL-të shkon në konsultime publike. c.5 Propozimi mbi themelimin e bordeve industriale në Universitetet që këshillojnë IAL-të është miratuar dhe fillon zbatimin.

	Prioritetet	Veprimet dhe treguesit
3.6	Përmirësimi i cilësisë së Arsimit dhe Aftësisit Profesional (AAP) dhe kalimit nga shkolla në punë.	<ul style="list-style-type: none"> a.1 Vlerësimi i Nevojave të Tregut të Punës (ë bërë në pikën 3.3) përdoret si bazë; a.2 Përmirësimi i cilësisë së sistemit të aftësisit profesional përmes harmonizimit të AAP me nevojat e tregut të punës përmes shqyrtimit të profileve të ofruara në shkollat e AAP-së dhe përafrimit të saj me vlerësimin e nevojave të tregut të punës; a.3 Hartimi i kurrikulave bërthamë për AAP dhe fillimi i fazës së pilotimit; a.4 Sigurimi i financimit të duhur për qendrat e AAP-së. b.1 Përmirësimi i rezultateve të arsimit dhe mbështetja e shkollave për kalim në tregun e punës përmes sigurimit të praktikave me punëdhënësit, janë zgjeruar dhe përfshirë në programet studimore.

SHTOJCA II

PROCESI I ANËTARËSIMIT NË BE PËR VENDET E BALLKANIT

PERËNDIMOR 22

Shqipëria

- Qershor 2006 - Nënshkrimi i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSAA) në Këshillin për Çështje të Përgjithshme dhe Marrëdhënie të Jashtme në Luksemburg;
- Prill 2009 – Hyrja në fuqi e MSA-së;
- Prill 2009 – Shqipëria dorëzon aplikacionin për anëtarësim në BE;
- Nëntor 2009 – Këshilli aprovon aplikacionin për anëtarësim në BE dhe e fton Komisionin Evropian që të dorëzojë opinionin për aplikimin;
- Nëntor 2010 - Komisioni publikon Opinionin e vetë për kërkesën për anëtarësim të Shqipërisë;
- Qershor 2011 – Miratimi i Planit të Veprimit dhe adresimi i 12 rekomandimeve kryesore të Opinionit të Komisionit mbi aplikimin e Shqipërisë për anëtarësim në BE;
- Tetor 2012 – Komisioni Evropian rekomandoi që Shqipërisë t'i jepet status i vendit kandidat, me kushtin që të ndërmerren disa masa në fusha të caktuara;
- Nëntor 2013 – BE-ja dhe Shqipëria e mbajnë takimin e parë të Dialogut të Nivelit të Lartë mbi Prioritetet Kryesore;
- Qershor 2014 – Shqipëria merr statusin e vendit kandidat.

Bosnja dhe Hercegovina

- Nëntor 2005 - Negociatat për Marrëveshje të Stabilizim Asociimit (MSA) zyrtarisht u hapën në Sarajevë;
- Qershor 2008 – Nënshkruhet MSA-ja;
- Qershor 2012 – BE-ja dhe Bosnja dhe Hercegovina lansojnë Dialogun e Nivelit të Lartë mbi Procesin e Anëtarësimit;
- Qershor 2015 – Hyja në fuqi e MSA-së me Bosnjën dhe Hercegovinën;
- Korrik 2015 – Këshilli i Ministrave të Bosnjë dhe Hercegovinës miratojnë Agjendën e Reformave të BE-së 2015-2018 të fokusuar në: Financa Publike, Taksimin dhe Qëndrueshmërinë Fiskale, Klimën e Biznesit dhe Konkurrueshmërinë, Tregun e Punës, Mirëqenien Sociale dhe Reformën Pensionale, Sundimin e Ligjit dhe Qeverisjen e mirë, si dhe Reformën e Administratës;
- Shkurt 2016 – Bosnja dhe Hercegovina dërgon aplikacionin e saj për anëtarësim në BE.

Kosova

- Shkurt 2008 – Këshilli e njuh deklaratën e shpalljes së pavarësisë së Kosovës, duke nënvizuar që Kosova është një rast sui generis;
- Tetor 2009 – Komisioni lëshon komunikatën “Kosova – realizimi i perspektivës së saj evropiane”;
- Tetor 2012 – Komisioni Miraton studimin e fizibilitetit për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (MSA) ndërmjet BE-së dhe Kosovës;
- Tetor 2015 – Nënshkruhet MSA-ja;
- Prill 2016 – Hynë në fuqi MSA ndërmjet BE-së dhe Kosovës;
- Maj 2016 – Komisioni propozon Agjendën e Reformave Evropiane (ARE).

Maqedonia

- Prill 2001 – Nënshkruhet Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA);
- Mars 2004 – Aplikimi për anëtarësim në BE;
- Prill 2004 – MSA-ja hynë në fuqi;
- Mars 2004 – Këshilli i kërkon Komisionit opinionin mbi aplikimin;
- Shkurt 2005 – Maqedonia i përgjigjet pyetësorit të BE-së;
- Nëntor 2005 – Komisioni Evropian lëshon opinion mbi aplikimin e ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Opinioni rekomandon dhënien e statusit kandidat për anëtarësim në BE;
- Dhjetor 2005 – Këshilli Evropian vendos të njoh statusin e vendit kandidat për anëtarësim në BE;
- Tetor 2009 – KE-ja rekomandon hapjen e negociatave për pranimit të vendit në Bashkimin Evropian;
- Mars 2012 – KE-ja lanson Dialogun e Nivelit të lartë me Shkupin.

Mali i Zi

- Tetor 2007 – Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) nënshkruhet në Luksemburg;
- Dhjetor 2008 – Mali i Zi aplikon për anëtarësim;
- Maj 2010 – MSA-ja hynë në fuqi;
- Nëntor 2010 – Komisioni lëshon një opinion të favorshëm për aplikimin e Malit të Zi, duke identifikuar shtatë (7) prioritet kryesore që duhet të adresohen para se negociatat të fillojnë, si dhe Këshilli ia aprovoi statusin e kandidatit;
- Dhjetor 2010 – Këshilli konfirmon Malin e Zi si vend kandidat;
- Dhjetor 2011 – Këshilli lanson procesin e anëtarësimit me Malin e Zi për të hapur negociatat në qershor 2012;
- Qershor 2012 – Këshilli Evropian përkrah vlerësimin e Komisionit që Mali i Zi përmbush kriteret për anëtarësim dhe mund të fillojë negociatat për anëtarësim më 29 qershor 2012; Deri më sot, Mali i Zi i ka hapur 24 Kapituj.

Serbia

- Tetor 2005 - Fillojnë negociatat për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (MSA);
- Maj 2006 – Negociatat për MSA pezullohen, sepse bashkëpunimi i Serbisë me Tribunalin Ndërkombëtar për Krime në ish-Jugosllavi nuk është përmirësuar;
- Prill 2008 – Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) nënshkruhet në Luksemburg;
- Dhjetor 2009 - Serbia aplikon për anëtarësim në BE;
- Tetor 2011 – Komisioni Evropian jep opinionin për aplikimin e Serbisë për anëtarësim në BE, duke i dhënë statusin kandidat bazuar në prioritetet kryesore;
- Mars 2012 – Këshilli i Evropës konfirmon Serbinë si vend kandidat;
- Qershor 2013 – Këshilli i Evropës përkrah rekomandimin e Komisionit për të hapur negociatat me Serbinë;
- Shtator 2013 - Hyrja në fuqi e Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asociim BE- Serbi;
- Dhjetor 2015 – Hapja e Kapitujve 32 “kontrolli financiar” dhe atij 35 “çështje tjera – Njësia 1: Normalizimi i marrëdhënieve ndërmjet Serbisë dhe Kosovës”;
- Korrik 2016 – Hapja e Kapitujve 23 dhe 24 që kanë të bëjnë me gjyqësorin, të drejtat themelore të njeriut, lirinë dhe sigurinë.